



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 63.4, neni 15.5 dhe neni 26 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 4 të Rregullës Zgjedhore nr.08/2013 për Certifikim të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të Tyre, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** me datë 28.08.2021 merr këtë:



V E N D I M

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për certifikimin e partisë politike **“Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës” (AAK)** dhe listës prej 29 (njëzet e nëntë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Deçanit, listës prej 38 (tridhjetë e tetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Gjakovës, listës prej 23 (njëzet e tre) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Glogocit, listës prej 31 (tridhjetë e një) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Gjilanit, listës prej 10 (dhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Dragashit, listës prej 29 (njëzet e nëntë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Istogut, listës prej 25 (njëzet e pesë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Kaçanikut, listës prej 29 (njëzet e nëntë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Klinës, listës prej 10 (dhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Fushë Kosovës, listës prej 26 (njëzet e gjashtë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Kamenicës, listës prej 8 (tetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën Mitrovicë e Jugut, listës prej 13 (trembëdhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Lipjanit, listës prej 22 (njëzet e dy) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Obiliqit, listës prej 34 (tridhjetë e katër) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Rahovecit, listës prej 38 (tridhjetë e tetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Pejës, listës prej 38 (tridhjetë e tetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Podujevës, listës prej 56 (pesëdhjetë e gjashtë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Prishtinës, listës prej 41 (dyzet e një) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Prizrenit, listës prej 21 (njëzet e një) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Skenderajt, listës prej 6 (gjashtë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Shtimes, listës prej 34 (tridhjetë e katër) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Suharekës, listës prej 43 (dyzet e tre) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Ferizajt, listës prej 13 (trembëdhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Vitisë, listës prej 20 (njëzet) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Vushtrrisë, listës prej 23 (njëzet e tre) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Malishevës, listës prej 17 (shtatëmbëdhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Junikut, listës prej 17

(shtatëmbëdhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Hanit të Elezit, listës prej 1 (një) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Kllokotit, si dhe nga 1 (një) kandidat për Kryetar të Komunës së e Deçanit, Gjakovës, Glogocit, Gjilanit, Dragashit, Istogut, Klinës, Fushë Kosovës, Kamenicës, Lipjanit, Obiliqit, Rahovecit, Pejës, Podujevës, Prishtinës, Prizrenit, Suharekës, Ferizajit, Vushtrrisë, Malishevës dhe Junikut, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

- II. Ky subjekt politik certifikohet për të marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvend në Komunën e Deçanit, Gjakovës, Glogocit, Gjilanit, Dragashit, Istogut, Kaçanikut, Klinës, Fushë Kosovës, Kamenicës, Mitrovicës së Jugut, Lipjanit, Obiliqit, Rahovecit, Pejës, Podujevës, Prishtinës, Prizrenit, Skenderajt, Shtimes, Suharekës, Ferizajit, Vitisë, Vushtrrisë, Malishevës, Junikut, Hanit të Elezit dhe Kllokotit si dhe për Kryetar të Komunës në Komunën e Deçanit, Gjakovës, Glogocit, Gjilanit, Dragashit, Istogut, Klinës, Fushë Kosovës, Kamenicës, Lipjanit, Obiliqit, Rahovecit, Pejës, Podujevës, Prishtinës, Prizrenit, Suharekës, Ferizajit, Vushtrrisë, Malishevës dhe Junikut.
- III. Zyra obligohet që të njoftoj partinë politike **“Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës” (AAK)** për marrjen e këtij Vendimi.
- IV. Subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim në të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje, jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për radhitjen në fletëvotim.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës – PZAP.